

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-ës
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-108/14

**Prishtinë,
19 Maj 2015**

Në çështjen juridike të:

M. I.

Serbi

Pala ankuese

kundër

K. K.

Gj.

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Sylejman Nuredini, Kryetari i Kolegjit, Esma Erterzi dhe Willem Brouwer , gjyqtarë, në ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/212/2013 (lëndët e regjistruara në AKP me numrat KPA06859 dhe KPA06861, të datës 21 gusht 2013, pas shqyrtimit të mbajtur më 19 Maj 2015, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Ankesat e paraqitura nga M. I., të regjistruara me numrat GSK-KPA-A-108/2014 dhe GSK-KPA-A-109/2014, janë bashkuar si një lëndë e vetme me numrin GSK-KPA-A-108/2014.
2. Refuzohet si e pabazuar ankesa e M. I. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/212/2013 i datës 21 gusht 2013, për sa i përket kërkesave të regjistruara në AKP me numrat KPA 06859 dhe 06861.
3. Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/212/2013 i datës 21 gusht 2013, për sa i përket kërkesave të regjistruara në AKP me numrat KPA 06859 dhe 06861.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 12 mars 2007 M. I. (në tekstin e mëtejme: paraqitësi i kërkesës) ka paraqitur dy kërkesa të ndara në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), duke vepruar si anëtarë i familjes së ngushtë, në emër të djalit të tij, K. I. (lënda e regjistruar me nr. KPA 06859) dhe vëllait të tij, I. I.(lënda e regjistruar me nr. KPA 06861) duke kërkuar vërtetimin e të drejtës pronësore për ngastrën nr. 4502/2 në sipërfaqe prej 00.05.00 ha dhe ngastrës nr. 4502/3 në sipërfaqe prej 00.05.00, përkatësisht, të dyja ngastrat ndodhen në vendin e quajtur Orize 2, Gjakovë (në tekstin e mëtejme: pronat e kërkuara)
2. Në kërkesa thuhet se pronat e kërkuara janë humbur për shkak të rrethanave të ndërlidhura me konfliktin e armatosur që ka ndodhur në Kosovë në vitet 1998/99, duke cekur 14 qershor 1999 si datën e humbjes. Paraqitësi i kërkesës ka shtuar se djali i tij dhe vëllai i tij i kanë fituar pronat e kërkuara në bazë të kontratave të qirasë por që paraqitësi i kërkesës nuk i ka paraqitur ato pasi që të dytë janë persona të zhdukur dhe se kontratat e qirasë kanë mbetur me ta kur janë kidnapuar.
3. Bashkë me kërkesën ai ka paraqitur edhe dokumentet në vijim:
 - Dy vendime për ndarjen e tokës për ndërtim (asnjë nga vendimet nuk kanë numra referues) të datës **6 maj 1999** të lëshuar nga K.K. i Gj.. Sipas vendimeve, K. K. i Gj. ka ndarë për K.

dhe I. I., ngastrat me nr. 4502/2 dhe nr. 4502/3, secila në sipërfaqe prej 00.05.00 ha, që ndodhen në rrugën "Orize 2" bb .

- Autorizimin nr.1226 të datës 6 prill 2009, i vërtetuar në Gjykatën Komunale të Nishit, në bazë të cilit paraqitësi i kërkesës e ka autorizuar H. S. që ta përfaqësojë në AKP dhe institucionet tjera relevante lidhur me pronën e kërkuar.
- Certifikata nr. 230-816/06 e lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Serbisë më 7 prill 2006, ku thuhet se 6 anëtarë të familjes së paraqitësit të kërkesës (përfshirë djalin e tij K. I.) janë kidnapuar në qershor 1999.

Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur një mori dokumentesh tjera që nuk janë relevante për zgjidhjen e kësaj lënde.

4. Më 17 qershor 2010 dhe 25 prill 2013, AKP-ja ka bërë njoftimin e pronave të kërkuara përmes publikimit në Gazetën për Njoftime nr.11. Gazeta dhe Lista i janë lënë kryetarit të fshatit i cili ka pranuar që do t'ia jap palës së interesuar si dhe t'i vendos në hyrje dhe dalje të Gjakovës. Publikimet e njëjta janë lënë në Komunë-Avokatit Publik, Zyra Kadastrale, Zyra Regjionale e AKP-së në Pejë, si dhe në OSBE, UNHCR, Agjencinë Kosovare për Privatizim dhe Avokatit të popullit.
5. Më 21 janar 2009, A. R. duke vepruar në emër të K. K.të Gj. (në tekstin e mëtejme: pala përgjegjëse në kërkesë), ka marrë pjesë në procedurë para AKP-së, duke kontestuar pretendimet e paraqitësit të kërkesës.
6. Në mbështetje të pretendimeve të tij pala përgjegjëse në kërkesës ka paraqitur si vijon:
 - Fletën poseduese nr.856 të lëshuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, Departamenti për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë në Gjakovë, më 29 dhjetor 2008 që tregon se ngastra nr. 4502/2, kullotë e klasës së 2-të dhe në sipërfaqe prej 00.01.94 ha që ndodhet në vendin e quajtur "Nakarade" është e regjistruar në emër të K. K. të Gj..
 - Certifikatën për të Drejtat e Pronës së Paluajtshme UL- 70705028-02280 të lëshuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, Departamenti për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë në Gjakovë, më 29 dhjetor 2008 që tregon se ngastra nr. 4502/3, kullotë e klasës së 2-të dhe në sipërfaqe prej 00.01.94 ha që ndodhet në vendin e quajtur "Nakarade" është e regjistruar në emër të palës së tretë.
 - Kopja e planit me datë 29 dhjetor 2008 ku prona është në emër të K. K. të Gj.
 - Kopja e planit me datë 29 dhjetor 2008 ku prona është në emër të palës së tretë
 - Deklarata e datës 6 janar 2009 nga përfaqësuesi i palës përgjegjëse në kërkesë në të cilën ai deklaroi se paraqitësi i kërkesës pretendon që e ka të drejtën pronësore ndaj ngastrave në bazë të ndoshta vendimeve të falsifikuara për ndarjen e pronave të lëshuar në Serbi.

- Autorizimin e datës 16 janar 2009 në bazë të cilit Kuvendi Komunal i Gjakovës e autorizoi A. R. që t'i përfaqësojë interesat e saj në AKP lidhur me objektin e kërkesës.
7. Sipas raportit të verifikimit të AKP-së, të datës 15 korrik 2007, 11 nëntor 2008 dhe 1 gusht 2012, vendimet e ndarjes së pronave të datës 6 maj 1999 janë verifikuar negativisht pasi që nuk janë gjetur në institucionet kompetente ndërsa fleta poseduese për ngastrën nr. 4502/2 dhe Certifikata për të Drejtat e Pronës së Paluajtshme për ngastrën nr. 4502/3 janë verifikuar pozitivisht që tregojnë se pronat janë regjistruar në emër të Kuvendit Komunal të Gjakovës dhe palës së tretë.
 8. Më 21 gusht 2013, KKPK-ja me vendimin e vet KPCC/D/A/212/2013 ka refuzuar kërkesat.
 9. Vendimi i KKPK-së i është dorëzuar M. I. (në tekstin e mëtejshëm: pala ankuese) më 7 shkurt 2014. Më 07 mars 2014, ai e ka kundërshtuar vendimin e Kolegjit të Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme. Ankesa i është dorëzuar palës përgjegjëse në ankesë më 20 qershor 2014, megjithatë, ai nuk ka parashtruar përgjigje.

Pretendimet e palës ankuese

10. M. I. pretendon se vendimi i KKPK-së përmban gabime thelbësore apo shkelje serioze të së drejtës materiale dhe se vendimi mbështetet në vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të fakteve.
11. Sipas palës ankuese, vendimi i kundërshtuar i KKPK-së është i padrejtë dhe ligjërish i paqëndrueshëm sepse, paragrafi 1 i dispozitivit, nën A, përcakton se kërkesa është hedhur poshtë, ndërsa në vazhdim, në paragrafin 57 të vendimit, është vendosur se kërkesa është refuzuar, kjo e bënë vendimin e paqartë dhe të pakuptueshëm, për shkak të kësaj nuk mund të vlerësohet nëse arsyeja e dhënë është për ta hedhur poshtë apo për ta refuzuar kërkesën.
12. Pala ankuese pretendon se Komisioni në mënyrë të gabuar ka vërtetuar faktet në bazë të cilave varet zbatimi korrekt i së drejtës materiale. Ai pohon se djali i tij dhe vëllai i tij e kanë fituar të drejtën pronësore ndaj pronave të kërkuara në pajtim me Ligjin mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore, në bazë të cilit u janë ndarë pronat e kërkuara, bazuar në transaksion ligjor, kryesisht në bazë të Vendimeve të Kuvendit Komunal të Gjakovës, të datës 6 maj 1999, kështu, Komisioni ishte obliguar, ex officio, t'i sigurojë të dhënat e kërkuara, nëse i njëjti ka dyshuar në kredibilitetin e dokumenteve të paraqitura nga ai, dhe pastaj në procedurë të veçantë të paraqes prova dhe me faktet e vërtetuara, kolegji duhet të kishte marrë vendim të ligjshëm dhe t'ia njëhte paraqitësit të kërkesës të drejtën pronësore ndaj pronës në pyetje.

Pretendimet e palës përgjegjëse në ankesë

13. Përfaqësuesi i Komunës së Gjakovës, pala përgjegjëse në ankesë, ka treguar se vendimet për ndarjen e pronave të paraqitura nga pala ankuese janë lëshuar nga një autoritet jo kompetent në kohën kur në Kosovë ishte gjendje lufte, dhe si të tillë nuk mund të prodhojnë asnjë efekt ligjor.
14. Në vazhdim, pala përgjegjëse në ankesë ka deklaruar se pronat e kërkuara nuk përputhen me gjendjen reale në terren. Ai tutje deklaroi se pala ankuese pretendon të drejtën pronësore ndaj pronave në bazë të ndoshta vendimit të falsifikuar të ndarjes së pronave të lëshuar nga Serbia.

Arsyetimi ligjor

Pranueshmëria e ankesës

15. Ankesa është paraqitur brenda afati prej 30 ditëve të përcaktuar me nenin 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079 dhe është e pranueshme.

Bashkimi i ankesave:

16. Neni 13.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 mund të vendosë mbi bashkimin apo shkrirjen e ankesave, kur një bashkim apo shkrirje e tillë e kërkesave është vendosur nga Komisioni në pajtim me nenin 11.3 (a) të ligjit. Ky nen i lejon Komisionit të marrë parasysh bashkimin apo shkrirjen e kërkesave në mënyrë që të shqyrtojë dhe merr vendime aty ku ka çështje të njëjta ligjore si dhe të provave.
17. Dispozitat e Ligjit të Procedurës Civile që janë të zbatueshme në procedura para Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme në pajtim me nenin 12.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, si dhe dispozita e nenit 408.1 në vështrim të nenit 193 të Ligjit nr. 03/L006 të Procedurës Kontestimore, ofrojnë mundësinë e bashkimit të kërkesave përmes një aktvendimi nëse kjo do të sigurojë efikasitetin e gjykatës dhe efektshmërinë e lëndës.
18. Në tekstin e ankesave të paraqitura nga pala ankuese, Gjykata Supreme vëren se përveç numrit të ndryshëm që janë paraqitur ankesat, faktet, baza ligjore dhe çështja e provave janë saktësisht të njëjta në të dyja lëndët. Vetëm ngastrat, subjekti i së drejtës pronësore që pretendohen në secilën kërkesë, janë të ndryshme. Ankesat janë të bazuara në deklaratë të njëjtë shpjeguese dhe në dokumentacionin e njëjtë. Për më tepër, arsyetimi ligjor i KKPK-së për kërkesat është i njëjtë.

19. Ankesat e regjistruara me numrat GSK-KPA-A-108/14 deri GSK-KPA-A-109/14 bashkohen në një lëndë të vetme me numër GSK-KPA-A-108/14.

Meritat e ankesës

20. Lidhur me pretendimin e palës ankuese se KKPK-së është i paqartë, KKPK-ja ka dhënë një vendim të vërtetuar të datës 21 gusht 2013, vendimi i referohet “paragrafëve relevante”. Një referencë e veçantë i është bërë paragrafëve 11, 56 dhe 57. Prandaj, Gjykata Supreme do të ofrojë një përmbledhje të shkurtër të arsyeve se pse KKPK-së **e refuzoi** lëndën.
21. Sipas nenit 3.1 të Ligjit Nr. 03/L-079, KKPK-ja ka kompetencë për zgjidhjen e kërkesave që ndërlidhen drejtpërsëdrejti me rrethanat apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. Kështu që, paraqitësi i kërkesës nuk duhet vetëm ta dëshmojë të drejtën e tij pronësore ndaj pronës së paluajtshme, por edhe të dëshmojë se ai apo ajo nuk është në gjendje tani ta ushtrojë atë të drejtë pronësore për shkak të rrethanave që ndërlidhen drejtpërsëdrejti apo rezultojnë nga konflikti i armatosur.
22. Edhe pse nga provat e paraqitura në KKPK mund të shihet se djalit të palës ankuese dhe vëllait të tij, gjoja u janë ndarë pronat e kërkuara më **6 maj 1999** (gjatë periudhës së konfliktit) ndërsa ai e cek 14 qershorin 1999 si datë të humbjes së saj, në atë mënyrë që e vë në dyshim çështjen e posedimit të pronave, KKPK-ja dhe Kolegji i Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme e konsiderojnë kërkesën nën juridiksionin e vet pasi që nuk ka asnjë provë që dëshmon të kundërtën.
23. KKPK-ja ka bazuar vendimin e vet në faktin se AKP-ja dhe Sekretaria Ekzekutive e KKPK-së kanë bërë verifikimin negativ të dokumenteve, në të cilat z. I. i bazon pretendimet e pronësisë, përfshirë Vendimet për ndarjen e pronave të datës 6 maj 1999. Sekretaria Ekzekutive e KKPK-së nuk ka mundur të sigurojë *ex officio* ndonjë provë që mbështesnin pretendimet e z. I. Eshtë i paqëndrueshëm pretendimi i ankuesit se AKP-ja nuk ka siguruar prova *ex officio* por se dokumentet të cilat i ka paraqitur ankuesi nuk janë gjetur pra nuk janë verifikuar pozitivisht. Në bazë të kësaj, KKPK-ja gjeti se z. I. nuk ka vërtetuar asnjë të drejtë pronësore ndaj pronës kontestuese.
24. Ankesat përsërisin pretendimet e njëjta të cilat i ka bërë ai para KKPK-së. Asnjë provë e rëndësishme nuk është paraqitur bashkë me ankesë.
25. Në pajtim me nenin 8.6 të Shtojcës III të UNMIK/ADM/DIR/2007/5 të miratuar me Ligjin nr.03/L-079, Komisioni mund ta refuzojë apo hedh poshtë një kërkesë mbi çfarëdo baze. Kërkesat mund të refuzohen nëse Komisioni apo Bartësi i së Drejtës Pronësore, sipas rastit, nuk kanë qenë në gjendje të dëshmojë pronësinë e tyre apo të drejtën e shfrytëzimit të pronës së kërkuar. Në këtë aspekt, Gjykata Supreme vëren se KKPK-ja, si në dispozitiv dhe në arsyetim, ka përdorur

terminologji duke refuzuar kërkesën, prandaj pretendimi i palës ankuese është i pabazuar dhe i paqëndrueshëm pasi që arsyetimi i vendimit të kundërshtuar është i qartë dhe i kuptueshëm.

26. Për më tepër, pronat janë të regjistruara në emër të K. K. të Gj., të palës përgjegjëse në ankesë. Pala ankuese nuk ka mundur ta vërtetojë të drejtën pronësorë të pretenduar apo posedimin e pronave para konfliktit. Prandaj, KKPK-ja ka vepruar drejtë kur e ka refuzuar kërkesën e paraqitur.
27. Gjykata Supreme gjen se KKPK-ja ka marr vendim të drejtë, të bazuar në një procedurë të plotë dhe të saktë. Prandaj, Gjykata Supreme gjen se nuk ka pasur shkelje të së drejtës materiale dhe as vërtetim të gabuar ose jo të plotë të fakteve. Gjykata Supreme gjen se ankesa është e pabazuar.
28. Nga arsyet e paraqitura e sipas nenit 13.3 (b) të Ligjit nr. 03/L-079, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë juridike:

29. Në pajtim me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Kryetar i kolegjit

Esma Erterzi, Gjyqtare e EULEX-it

Willem Brouwer, Gjyqtar i EULEX-it

Urs Nuffer, Referent i EULEX-it